



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3721/2026  
Data: 22.04.2026

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tretë -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.03.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
3. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të NPL Pastrimi Sha.
5. Informatë mbi përjashtimin e nxënësve në shkollën e mesme "Dardania"
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson: - për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlasi** thekson: - për këto dy pikat e fundit nuk kemi material dhe nuk duhet të procedohen pikat pa material dhe ne jemi marrë vesh në Komitet për Politikë e Financa që me material shtesë me na i përcjellë. Na as që mund të diskutojmë as për përjashtimin e nxënësve, as për pikën tjetër që ku merren mjetet financiare dhe ku dedikohen. Kam edhe një vërejtje sepse nuk e di se si ka shkuar më herët, por kam dëshirë që me u respektuar Ligji edhe prej anës së juve edhe prej anës sonë, sepse po injorohemi si Kuvend. Kemi pyetje që i kemi parashtruar Kryetarit të Komunës dhe drejtorive qe dy muaj, por nuk na kanë kthyer përgjigje. Afati ligjor është dy muaj, unë mundem me marrë edhe tjera veprime demokratike, por nuk është në rregull se na po injorohemi për shkak se bëjmë pyetje sikur nuk kemi bërë hiq. Ligji duhet të respektohet, përndryshe nëse vazhdoni kështu ne duhet të marrim veprime tjera demokratike dhe nuk do të rrimë në mbledhje dhe kështu unë e lëshoj mbledhjen së bashku me anëtarët e mi.

**Kryesuesi** thekson: - prej diskutimit që e diskutove unë mundem me të arsyetuar për pyetjet të cilat ju ke drejtuar drejtorëve që ndoshta nuk t'i kanë sjellë me kohë. Unë pajtohem që ka Ligj dhe rregullore dhe ka afat. Te pika e rendit të punës "Informatë mbi përjashtimin e nxënësve në shkollën e mesme 'Dardania'", që ke insistuar atë ditë së bashku me kolegët e tu, unë paraprakisht të kam njoftuar që me pritë për shkak se drejtori nuk është prezent, por me qenë prezent drejtori në mënyrë që t'i drejtohesh më konkret se çka duhet me të informuar. Por ju keni insistuar dhe keni ardhur në atë që unë kam potencuar atë ditë. Ju insistuat me shty në rend të ditës dhe nuk e di se çka jam duke bërë diçka të padrejtë që po potencon ty që po injorohemi.

**Menduh Vlashi** thekson: - nuk procedohet pika e rendit të punës pa material, se nuk dimë se çka flasim, por ju duhet të thoni që këto pika i shtyjme për mbledhjen tjetër sepse nuk kemi material.

**Kryesuesi** thekson: - prezent e keni drejtorin këtu dhe materialin e ka e ua prezanton, por nëse është i mjaftueshëm materiali ne mund ta vazhdojmë.

**Menduh Vlashi** thekson: - ju faleminderit dhe kësaj radhe ne po e lëshojmë mbledhjen në mënyrë demonstrative pse na injoroni si këshilltarë dhe ju të pozitës keni kujdes sepse kuvendi është organi më i lartë dhe ata duhet me na raportuar neve e jo ne atyre.

**Basri Dernjani** thekson: - sa i përket pikës së tretë të rendit të punës kjo ka qenë e kërkuar në mbledhjen e kaluar dhe në këtë seancë jemi në rregull me procedurë ligjore.

**Kryesuesi** thekson: - a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri,

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

##### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

##### 2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Basri Dernjani** thekson: - si kryesues e kam analizuar këtë material dhe rekomandimet të cilat i ka dhënë komiteti për komunitete i mandatit të kaluar janë duke u zbatuar në përpikmëri sepse i kemi mbajtur mbledhjet dhe të gjithë drejtorët kanë qenë prezentë.

**Sead Vila** thekson: - edhe unë e kam adresuar qysh kur është zgjedhur ky komitet se nga qeverisja e kaluar ka pasur neglizhencë apo anashkalim nga drejtoritë që mos me marrë pjesë në takimet që i ka ftuar komiteti për komunitete. Edhe unë jam i kënaqur në këtë fazë me drejtoritë që kanë marrë pjesë në takimet që i kemi pasur. Uroj që të vazhdojnë edhe me drejtorët e tjerë apo zyrtarët e tjerë që mos ta neglizhojnë ftesën, në mënyrë që t'i diskutojmë shqetësimet që i kemi si asamblistë, por edhe kërkesat të cilat vijnë nga qytetarët.

**Kryesuesi** thekson: - a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### 3. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson: - përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson: - a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të NPL Pastrimi Sh.A.

**Kryesuesi** thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Basri Dernjani** thekson: - po më vjen keq që grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk është në sallë, ky propozim është prej mbledhjes së kaluar. Kur e kemi pasur pasqyrën financiare të NPL Pastrimi e kemi analizuar dhe e kemi parë që, duke e parë rritjen e cila ka vazhduar me anë të inflacionit, të hyrat e kompanisë nuk kanë qenë të mundshme për rritjen e buxhetit të pagave, prandaj ne si kuvend, pasi që jemi bashkëthemelues të NPL Pastrimi si aksionarë, kërkoj që ne si kuvend t'i ndajmë 25 000 € për ngritjen e pagave për punëtorët e kësaj kompanie. Ligji i pagave e parasheh që paga minimale fillon së zbatuari nga muaji qershor 2026, atëherë ne në bazë të ligjit jemi në mungesë dhe kërkoj që kompaninë ta subvencionojmë me një shumë prej 25 000 € për shkak se buxheti është i vogël dhe çmimi për zbrazjen e deponisë dhe i naftës është ngritur.

**Sead Vila** thekson: - gjithmonë e kam vlerësuar punën të cilën e bëjnë punëtorët e NPL Pastrimi edhe sot e kësaj dite e mbështes punën të cilën e bëjnë ata në terren, por në seancën e datës 26.02.2026, znj. Medina Imishti e paraqiti shifrën e mospërputhjes së pagave për vitin 2025 dhe 2026, sepse në vitin 2026 ishin më të ulëta se në vitin 2025. Po ashtu edhe unë kam potencuar se bien në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Kosovës për shkak se nga muaji janar kanë marrë pagë nën minimale. Unë jam pro kësaj rritjeje, por para se me ardhur në seancë është dashur ta kemi një material në mënyrë që ta kishim analizuar se a ka nevojë të shtohet ky buxhet, por me gjithë atë e paskan menduar qoftë si individ apo si grup, siç e keni menduar, unë jam pro që të bëhet një ngritje që edhe ata punëtorë të kenë të ardhura të dinjitetshme, por edhe që nuk bien në kundërshtim me pagën minimale.

**Mehmet Ballazhi** thekson: - është e vërtetë që e kemi diskutuar qoftë në kuvend apo edhe jashtë kuvendit apo edhe jashtë protokolleve, por ka nevojë për rritje. Unë këtë çështje e kam diskutuar me kryeshefin e kompanisë dhe paga bazë që e kanë ata është mbi 500 € për shkak të ndërrimeve që i kanë dhe orëve që i mbërrijnë, pra asnjë punëtor nuk është nën 500 € me shtesat që i kanë, mirëpo qëllimi është me rrit pagën bazë sipas Ligjit që po besoj që pajtohet gjithsecili për punën të cilën po e kryejnë.

**Kryesuesi** thekson: - a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR RITJEN E BUXHETIT TË NPL PASTRIMI SH.A. EDHE PËR 25 000 €**

## 5. Informatë mbi përjashtimin e nxënësve në shkollën e mesme "Dardania"

**Kryesuesi** thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson: - në bazë të njoftimit nga drejtori i shkollës dhe raportimeve nga kujdestarët e klasave nga shkolla e mesme Dardania dhe në bazë të informatave të shefit të arsimit është konstatuar se një numër i nxënësve kanë tejkaluar kufirin e lejuar të mungesave të paarsyeshme duke arritur mbi tridhjetë e dy mungesa. Me udhëzim administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe në bazë të rregulloreve të brendshme të arsimit, vijueshmëria e rregullt e mësimit është obligative, edhe kur e dimë se shkollimi i mesëm është shkollim vullnetar, dhe tejkalimi i numrit të mungesave të paarsyeshme përbën shkelje të rëndë të disiplinës dhe detyrimeve shkollore, për të cilën parashihen edhe masa disiplinore. Drejtorja dhe këshilli kanë marrë masa. Përkundër masave parandaluese të ndërmarra nga shkolla, që përfshijnë njoftimin e vazhdueshëm nga ana e prindërve përmes kujdestarëve dhe këshillit të prindërve, si dhe përpjekjet për riintegrim në procesin mësimor, nga njëherë edhe duke i mbingarkuar apo amnistuar nga mungesat e paarsyeshme konform ligjit, si dhe duke i mbingarkuar mësimdhënësit që t'i mbajnë në klasë, me gjithë ato probleme që i kanë pasur nxënësit, përsëri nxënësit në fjalë nuk kanë treguar përmirësim për sjellje të vijueshmërisë. Si rezultat, bazuar në këto rrethana dhe në bazë të kompetencave ligjore, drejtorja e shkollës ka marrë vendim për pezullim të përkohshëm nga procesi mësimor, si masë disiplinore për nxënësit që kanë mbi tridhjetë e dy mungesa të paarsyeshme, me qëllim të garantimit të rendit në SHML, mbrojtjen dhe zhvillimin normal të procesit mësimor dhe nxitjen e përgjegjësisë individuale të nxënësve ndaj obligimeve shkollore. Ajo që vlen të ceket është se ky vendim i marrë nga shkolla nuk përbën rrezik që nxënësit të mbeten pa shkollim, por do t'i nënshtrohen provimeve në klasë në fund të vitit shkollor, ashtu siç është e përcaktuar me ligjet dhe udhëzimet administrative për arsimin parauniversitar.

**Kryesuesi** thekson: drejtori, materialin duhesh me e shpërndarë e jo me e pasur vetëm për vete. Të njëjtin prezantim, të cilin e bëre, ke mundur me na e ofruar materialin në mënyrë që mos me na qit neve keq tash.

**Sead Vila** thekson: për mua kjo është temë e rëndësishme, mirëpo më me rëndësi kishte me qenë për anët pozitive që i kemi, që mund të krahasohemi me shkollat e tjera për diçka që jemi më mirë, por në pikat ku qëndrojmë më keq, ne me punuar në atë drejtim që me u përmirësuar dhe me i arritur apo me i tejkaluar shkollat e tjera në komunat e tjera në nivel të arsimit. Unë mendoj që, sa do që e diskutojmë këtu, nuk mundemi me zgjidhur problemin, por i propozoj drejtorisë së arsimit që me krijuar një ekip apo një komision, në bazë të kompetencave që i ka, për me organizuar një punëtori me personat të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt apo indirekt me arsimin. Me bërë një gjithëpërfshirje, por edhe nga DKA-ja, drejtorët e shkollave, mësimdhënësit, prindërit, policia dhe persona të tjerë të cilët mund të kontribuojnë. Me adresuar një punëtori një- apo dyditore, në mënyrë që me i adresuar problemet. Ka probleme të cilat nuk janë vetëm në shkollën e mesme, por ndoshta kanë filluar që nga klasa e katërt, shtatë apo në klasën e tetë, kështu që me u bërë një gjithëpërfshirje nga niveli fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë, por nëse e shihni të arsyeshme edhe prej kuvendit, në mënyrë që me dhënë kontribut.

**Hisni Luri** thekson: drejtorja e arsimit është e hapur për çfarëdo bashkëpunimi apo ideje që e keni për të mirën e nxënësve. Nuk jemi këtu thjesht për me gëzuar njëfarë privilegji, por më shumë njëfarë përgjegjësie për ata nxënës, kështu që kurdo që së bashku mund ta organizojmë këtë, ne e bëjmë pa problem. Por nuk kishim pas qejf që, si njohës të fushës së arsimit, me pas tendenca për diçka dhe ne ashtu informatën e kemi për vitin shkollor, dhe nëse doni me bërë njëfarë ndryshimi apo përmirësimi, atëherë drejtohuni te organi kompetent. Nuk po them për këtë pikë konkrete, për shkak se përmes kuvendit nuk mundesh me zgjidhë një çështje. Mundesh me bërë politikë, ama po duam me e pavarësuar, në njëfarë forme, arsimin prej politikës. Jam këtu për çfarëdo bashkëpunimi për të mirën e nxënësve.

**Mehmet Ballazhi** thekson: kemi bërë përpjekje që me bashkëpunuar me gjithsecilin faktor që ndikon në rritjen e cilësisë së arsimit dhe në mbarëvajtjen e arsimit në përgjithësi. Sipas pikës që është informatë mbi përjashtimin e nxënësve në SHML “Dardania”, për të cilën është kërkuar informacion, drejtori e dha informacionin sipas rregullores që është për shkollat dhe sipas ligjit, ndërsa bashkëpunimin për me rritur cilësinë në arsim mund ta diskutojmë qoftë me një pikë se cila është më e mirë e kësaj pune. Informata që është kërkuar i ka afatet për të cilat ne japim informatë për secilën, siç janë informatat e KKS-së, informata për fillimin e vitit shkollor, informata për përfundimin e vitit shkollor; pra janë informata që ka me i marrë secili. Nëse ka ndonjë shkelje të rregullores që është për përjashtim, e që në këtë rast nuk është përjashtim, por është një masë parandaluese, ashtu siç e shpjegoi edhe drejtori, që ata do t’i nënshtrohen provimeve, që do të thotë nuk është përjashtim.

**Medina Imisht** thekson: këto që janë të fushës së arsimit e kanë më lehtë me diskutuar këtë çështje, por unë propozoj që kjo pikë e rendit të punës me u shtyrë për mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që me pasur para vetes materialin e drejtorisë. Drejtori potencoi që në kuvend nuk mundemi me zgjidhur problemin, por pak më herët e zgjidhëm bashkërisht si kuvend një problem të kompanisë “Pastrimi”, dhe për këtë punë jemi bashkë.

**Hisni Luri** thekson: ndoshta nuk më ke kuptuar drejt, por ideja ishte që për këtë pikë do të isha shumë mirënjohës nëse ju e kishit zgjidhur problemin e procesit mësimor ose vijueshmërinë e rregullt të procesit mësimor. A ta merr mendja që e kishim rregulluar përmes kuvendit këtë pjesë? Unë besoj që jo; nuk rregullohet vijueshmëria e nxënësve. Ngritjen e cilësisë e kërkoj dhe jam shumë i hapur për çfarëdo kritike që jepni, por nuk rregullohet vijueshmëria të shkolla në kuvend. Me shumë investimet që i kemi bërë, ndoshta ka shumë faktorë që e determinojnë këtë proces, por ideja është me dhënë këtë informatë pse ka ndodhur. Informatën e kemi përpara dhe do t’ua përcjell; nuk ka diçka private dhe është dashur të shkolla me shkuar me i marrë, sepse drejtorja e arsimit nuk i ka lëshuar këto vendime, për shkak se drejtorja e shkollës është e pavarur nga vendimet të cilat i merr konform ligjit. Andaj nuk duhet të jemi tinëzuar që t’i pyesim profesorët natën, ditën, çka është bërë dhe pse i keni përjashtuar; pse duhet me ndodhë kjo, pse duhet me ardhur në kuvend? I njihni proceset e arsimit shumë mirë dhe mund të shkoni të parashtroni një kërkesë të drejtorja e shkollës dhe ta jep informacionin, dhe nuk ka nevojë me ardhur dhe me bërë politikë këtu, por nëse ka nevojë me bërë politikë, hajde bëni politika të drejta.

**Kryesuesi** thekson: - parafolësi më herët nuk potencoi diçka keq, por potencoi që të bëhemi bashkë dhe ta shikojmë se si të parandalojmë këtë çështje, se me një farë forme është bërë trend dhe nuk je duke thënë diçka, as politikë, sa munda unë të kuptoj, nuk je duke bërë. Kjo, si e potencon ti dhe si ke ardhur pa kurrfarë materiali, nuk është e arsyeshme, sepse ne u mirëkuptuam, por po na qet në një pozitë që personat e lëshojnë sallën; jo që bëhem merak për këtë punë, por të paktën mos shit moral që je në të drejtë. Jemi duke të kuptuar edhe ty se nuk je fajtor pse përjashtohen nxënësit, por kërkesa e z. Sead Vila ka të bëjë me këtë që janë përjashtuar nxënësit. Hajde të bëhemi bashkë dhe ta eliminojmë këtë dukuri, sepse kjo është e kahmotshme, dhe të bëhemi bashkë e ta bëjmë më mirë.

**Basri Dernjani** thekson: - ne jemi këtu në aspektin politik, ndërsa sa i përket përjashtimit të nxënësve, rregulloren shkolla e ka në një nivel të lartë, që është e udhëzuar prej Ministrisë, dhe si informatë besoj që nuk ka pasur nevojë të vijë si pikë e rendit të punës, sepse e kemi informatën gjashtëmujore që jep drejtori për suksesin, për mungesat dhe për përjashtimet. Për të bërë politikë, ndoshta Aleanca ka dashur të bëjë politikë pse janë përjashtuar nxënësit, por drejtorja e shkollës së mesme e ka një rregullore dhe thirrret në atë rregullore që e potencoi edhe drejtori, prandaj nuk kemi nevojë këtu të diskutojmë për politika që ndoshta mund të na ndjekin pas kësaj mbledhjeje.

**Kryesuesi** thekson: - edhe në KPF kam potencuar që nuk ia vlen, por insistuan, sepse edhe drejtori nuk ishte prezent, për shkak se, po të ishte drejtori, më konkretisht do të jepte informacione.

**Mehmet Ballazhi** thekson: - po më duket e tepërt për të dalë jashtë rendit të ditës, sepse nëse pika e rendit të ditës ka qenë informatë rreth përjashtimit të nxënësve të shkollës së mesme "Dardania", informacioni u dha dhe është e panevojshme të dalë përtej kësaj; dhe nëse është e nevojshme të kemi shifra, ne t'i kërkojmë lirshëm për informatë, sepse nuk po dihet a është pika e rendit të ditës e ndryshme apo informata. Në fillim e përkraha z. Sead Vila për mënyrën që e paraqiti një çështje rreth bashkëpunimit për të ngritur cilësinë në arsim dhe ne mundemi të caktojmë një kohë për të diskutuar për këtë çështje, por jo të dalim jashtë pikave të rendit të punës, sepse u dhanë informatat. Nuk pajtohem me znj. Medina Imishti që kërkon të shtyhet, për shkak se informata u dha, dhe ne mundemi të shtojmë ndonjë pikë të re të rendit të ditës për ndonjë çështje të caktuar e jo për këtë. Çka duhet të japim informacion tjetër më për këtë çështje?

**Medina Imishti** thekson: - në KPF e diskutuam që, nëse drejtori nuk ka mundësi të përgatisë informatën, ne e kalojmë për mbledhjen e ardhshme. Unë nuk po them që vetëm të shtyhet dhe të grumbullohen pika, por unë e kam të vështirë, sepse nuk jam e fushës së arsimit, për të diskutuar sot këtë informatë dhe nuk e kam as personale, as politike. Nëse bëjmë politikë, neve të gjithëve politika na ka prurë këtu dhe askënd nuk e ka prurë diploma e shkollës, dhe nuk bëjmë dëm edhe pse bëjmë politikë; por edhe pse unë nuk po e them për politikë, po e them për diskutim, sepse unë nuk munda, përderisa e potenco i drejtori, të marr informacione.

**Mehmet Ballazhi** thekson: - unë ju kuptoj, por nuk kemi se çka të diskutojmë, sepse nëse është kjo pikë për një mbledhje tjetër dhe nëse duhet një informacion, e dha drejtori; por nëse ju duhet me shkrim, vetëm ua përcjell.

**Hanumshahe Dibrani** thekson: - sa është numri i nxënësve të cilët janë përjashtuar?

**Hisni Luri** thekson: - numri i nxënësve është njëzet e nëntë dhe shumica janë maturantë. Unë nuk e fajësova asnjërin prej tyre, por vetëm desha t'ju tregoj që ne do të kishim bërë një punë shumë të madhe që, nëse e zgjidhim këtë problem, qoftë në cilësi, qoftë edhe në vijueshmëri të nxënësve përmes kuvendit; por me një ekip mundemi ndoshta të bëjmë diçka, përndryshe përmes kuvendit vetëm mundemi të marrim informacione.

**Kryesuesi** thekson: - nxënësit të cilët janë maturantë, a kanë të drejtë të marrin pjesë në maturë? A kanë të drejtë të shkojnë nëpër ekskursion? Është mirë të marrim një vendim për të gjithë nxënësit, e jo dikujt t'ia lejojmë e dikujt të mos ia lejojmë. Vendimi i drejtorit të shkollës të merret dhe të zbatohet ashtu siç e përcakton ligji.

**Hisni Luri** thekson: - sa i përket përfshirjes në ekskursion, është këshilli i prindërve dhe këshilli i mësimit të nxënësve që e organizojnë një ekskursion të tillë, por ne vetëm mund të japim leje që të organizohet apo jo; për këtë përgjegjës janë këshilli i prindërve, kujdestarët e klasave dhe drejtorja e shkollës.

**Kryesuesi** thekson: - a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 6. Të ndryshme

**Kryesuesi** thekson: - për këtë pikë të rendit të punës, hap diskutimin.

**Shefket Lusnjani** thekson: - kërkoj nga drejtoria e bujqësisë që të parashtojë kërkesë në institut që të bëhen analizat e ujit në fshatin Gorancë, për shkak se ka pasur të reshura të shiut. Po i afrohem datës së shënimit të Ditës së Dëshmorëve për Feriz dhe Xhevdet Guri dhe kërkoj nga Drejtoria për Shërbime Publike që të rregullohet rruga deri te pllaka përkujtimore.

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: - jemi në diskutim me Institutin e Shëndetit Publik, për shkak se ka skaduar kontrata, dhe besoj që do të ripërtërihet dhe analizat e ujit do të bëhen jo vetëm për rajonin e Gorancës, por për tërë rajonin e komunës sonë.

**Senad Kalsi** thekson: - jam i informuar për gjendjen e rrugës e cila është atje dhe besoj që, për datën përkujtimore, do të jetë në rregull.

**Medina Imishti** thekson: - kam shqetësim prej pacientëve, sepse nuk janë duke u kryer një numër i madh i analizave në QKMF.

**Kimete Kuka-Hasallari** thekson: - shqetësimi i pacientëve ka ardhur edhe te unë, por për shkak të skadimit të kontratës dhe tash jemi në proces të kontratës së re, për të cilën kërkohet kohë, edhe pse normalisht kam kërkuar nga zyra e prokurimit që kjo procedurë të bëhet me përshpejtim, siç e parasheh ligji. Procedurat janë në proces dhe, deri në momentin që do të lidhet kontrata, jemi në mungesë të materialeve laboratorike.

**Sead Vila** thekson: - me një takim me një fermer, pra z. Besim Vila, i cili pretendon që është fermieri më i madh në komunën e Hanit të Elezit, i cili i ka gjashtëdhjetë krerë lopë, por kërkon që t'i lehtësohet veprimtaria e punës së tij që e ka në fushën e blegtorisë. Kërkon që distanca e rrugës, e cila është afër tetëdhjetë metra, është e vështirë të kalohet në këmbë, e lëre më me makineri. Po ashtu kërkon që t'i subvencionohet qumështi, për shkak se shumë komuna e aplikojnë me dhjetë centë për litër. Shoqëria civile mirë që po përfshihet nëpër komisione apo komitete, por ajo që nuk po më pëlqen kur po e shoh që po shënon shoqëri joqeveritare, por kisha kërkuar që të ceket se çka përfaqësojnë ata. I kemi bërë disa shkelje në seancat e kaluara, ku anëtari i kuvendit nga subjekti politik propozohet si shoqëri civile. Është mirë që ata, me një anë të një thirrjeje, të paraqesin kërkesën te kryesuesi për me qenë anëtarë në ndonjë komision, sepse kanë propozuar, qoftë nga LDK-ja, qoftë nga PDK-ja, anëtarë për shoqëri civile, e ne nuk e dimë se në cilën OJQ bëjnë pjesë ata.

**Ferdi Topojani** thekson: - ne si lagje në Han të Elezit, në lagjen Neqafçë, kemi një problem me rrymë si gjithë lagjet e tjera, mirëpo problemi ynë është pak më i veçantë, sepse si lagje jemi në qytet, por me sistem të rrymës jemi të kyçur me fshatin Paldenicë dhe Dermjak. A ekziston mundësi që komuna, në bashkëpunim me KEDS-in, lidhjen me e bërë me Han të Elezit apo përmes fabrikës?

**Abduraman Bushi** thekson: - sa i përket rastit të fermerit z. Besim Vila, kam biseduar dhe jemi pajtuar që nga viti i ardhshëm mundet me filluar, për arsye se ne nuk kemi paraparë buxhet për këtë financim. Për me u financuar, qumështi duhet të dërgohet nëpër pika grumbulluese e jo ky që shpërndahet nëpër shtëpia.

**Sead Vila** thekson: - gjatë fushatës, kur e keni vizituar, keni potencuar që do ta subvenciononi menjëherë për kërkesat të cilat i ka si blegtor.

**Abduraman Bushi** thekson: - unë gati se çdo javë jam në kontakt me të, por deri tash nuk i ka mjelë lopët, por kryesisht i ka përdorur për viça dhe qumështin, të cilin e dorëzon nëpër shtëpi private, nuk pranohen ato fatura. Unë ju kam treguar që, nëse doni me ua paguar qumështin, duhet ta dorëzoni nëpër pika grumbulluese, pra duhet të jetë kontrolli prej AVUK-ut dhe duhet të jenë faturat e dorëzimit, pastaj vazhdohet me procedura. Asnjë komunë nuk i paguan fermerët të cilët qumështin e dorëzojnë nëpër shtëpia private, por vetëm nëpër pikat grumbulluese.

**Senad Kalisi** thekson: - ne kemi qenë në vend të ngjarjes dhe e kemi parë rrugën dhe i kemi treguar fermerit që, brenda dy apo tri javësh, ajo rrugë ka me u shtruar me zhavorr.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:56.

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

